

Banka e Shqipërisë

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR

T3 - 2011

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

TETOR 2011


Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autoreve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

I	BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR	4
II.	NDËRMJETËSIMI BANKAR SIPAS MOMEDHËS	8
II.1	Ecuria e ndërmjetësimit në lekë	8
II.2	Ecuria e ndërmjetësimit në valutë (Euro)	9
II.3	Ecuria e elementeve jokosto në ndërmjetësim	11
	ANEKSI	13

1. BANKAT DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR


Sistemi bankar, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, ka grumbulluar më shumë fonde nga publiku dhe ka rritur financimin për ekonominë. Gjithsesi, bankat vijojnë të jenë të kujdesshme në kreditimin e sektorit privat të ekonomisë. Raporti i portofolit të kredisë ndaj stokut të depozitave, në fund të muajit gusht shënonte 60%, duke qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2010. Rritja e lartë e depozitave përgjatë gjithë vitit është shoqëruar nga përmirësimi gradual i normave vjetore të rritjes së aktivitetit kreditues. Zhvillimet pozitive në depozitat e sistemit bankar kanë reflektuar orientimin e sjelljes së individëve drejt kursimit. Tendenca për të kursyer e individëve në vitet e fundit është në përgjigje të perceptimit për një pasiguri të shtuar për të ardhmen si për zhvillimet ekonomike në vend (në tregun e punës) ashtu edhe për tregun ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë mungesa e sinjaleve për gjallërim të dukshëm të konsumit, duket se është reflektuar në një kërkesë të ulët të individëve për kredi si dhe në ecurinë e moderuar të aktivitetit ekonomik të bizneseve. Këta të fundit vijojnë të shfrytëzojnë pjesërisht kapacitet prodhuese dhe për pasojë të shfaqin një kërkesë të ulët për financim nga sistemi bankar, në veçanti për kredi për investime. Ndërkohë, edhe nga ana e ofertës për kredi, bankat vijojnë të ndjekin politika të kujdesshme në kreditim, të ndikuar nga ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë dhe pasiguritë për situatën makroekonomike në të ardhmen.



Në fund të muajit gusht, rreth 46.6% e aktiveve të sistemit bankar janë të investuar në portofolin e kredisë për ekonominë, duke mbetur në të njëjtin nivel sikurse një vit më parë. Raporti i kredisë ndaj PBB arriti në 39.4%, rreth 1 pikë përqindjeje më i lartë se fundi i vitit 2010. Ndërkohë, stoku i depozitave përfaqëson rreth 76% të pasivit, krahasuar me 75.3% një vit më parë. Për këtë periudhë vlerësohet se raporti i depozitave ndaj PBB-së shënoi rritje në 66%, ose 2 pikë përqindjeje më lartë se sa në dhjetor 2010. Ecuria e mirë e grumbullit të fondeve ka ndikuar në rritjen e monetizimit të ekonomisë, e shprehur në rritjen e raportit të M3 ndaj PBB-së, në 80.5%. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, raporti i kredive ndaj depozitave në fund të muajit gusht, ishte rreth 1 pikë përqindjeje më i ulët se në fund të tremujorit të dytë.

Ecuria e ndërmjetësimit sipas grupbankave, ka dëshmuar për një performancë më të mirë të bankave të vogla në tregun e kredihënies, të cilat kanë rritur më tej portofolin e tyre të kredisë, duke balancuar kontraktimin e portofolit të bankave greke. Pjesa e tregut të kredisë së bankave të vogla arriti në 21.3%, krahasuar me 18.7% që shënonte në fund të vitit 2010. Portofoli i bankave greke vazhdon të tkurret, i ndikuar nga ndryshimi i strategjisë së këtyre bankave gjatë viteve të fundit. Pjesa e bankave greke në sistem arriti në 26.6%, krahasuar me 30% që ishte në fillim të vitit 2011. Ndërkohë, rritja e qëndrueshme e portofolit të kredisë së bankave të mëdha ka ndihmuar në një rritje të moderuar të pozicionit të tyre dominues në tregun e kredisë, në 41.3%.

Grafik 2. Pjesa e grup-bankave në totalin e depozitave dhe kredisë së sistemit bankar.



Në fund të muajit gusht, tregu i depozitave nuk ka shfaqur ndryshime në krahasim me një vit më parë. Grup i bankave të mëdha zë rreth 58.6% të këtij tregu, nga 58.4% që ishte një vit më parë. Bankat greke kanë mundur të mbajnë të pandryshuar pjesën e tregut në më shumë se 2 vjet, në rreth 19%. Ndërkohë, grupi i bankave të vogla ka shfaqur një rritje të moderuar të depozitave krahasuar me fundvitin 2010, duke zotëruar rreth 17% të tregut të depozitave, në fund të muajit gusht 2011.

Zgjerimi i stokut të depozitave i ka ndihmuar bankat të kenë likuiditet të bollshëm dhe të mos ketë presione mbi ecurinë e normave të interesit në tregun e parasë dhe atë financiar. Ecuria e depozitave ka qenë pozitive, duke shënuar përgjatë gjithë vitit ritme të larta rritjeje, rreth 14.2%. Në veçanti depozita në lekë kanë ruajtur një ritëm konstant vjetor të rritjes së tyre. Kjo ecuri pozitive e depozitave në lekë është mbështetur nga krijimi më i lartë i parasë në monedhën vendase, sidomos në pjesën e parë të vitit. Ndërkohë, në tremujorin e tretë vihet re një krijim më i madh i parasë në valutë, i ndikuar pozitivisht nga ecuria sezonale e treguesve. Nga ana tjetër kërkesa më e ulët e qeverisë për financim nga bankat, duket se ka ndikuar në ngadalësimin e krijimit të parasë në lekë. Depozitat në lekë ndaj totalit të depozitave, në muajin gusht, përbëjnë 51.6%, dhe janë në rënie krahasuar me fundin e tremujorit të dytë, kur ato përbënin 53.2%. Ndërkohë, depozitat në valutë të përkrahura nga prurjet e valutës së huaj nga emigrantet dhe aktiviteti turistik në vend, kanë shfaqur rritje të peshës ndaj depozitave totale në 48.4%, në fund të muajit gusht. Gjithashtu, vlerësohet se zhvendosja e strukturës së depozitave drejt depozitave në valutë, krahas krijimit të parasë nga kreditimi në valutë, mund të jetë ndikuar edhe nga tendenca e përdorimit të monedhës së huaj si mjet kursimi. Aktualisht sjellja e kujdesshme e individëve drejt kursimit ka nxitur dhe rritjen e depozitave në valutë. Struktura kohore e depozitave gjatë vitit 2011, dëshmon për rritje të peshës së depozitave me afat ndaj totalit. Kjo sjellje është në linjë edhe me orientimin e individëve për të kursyer dhe për të shpenzuar më pak. Po kështu edhe forcimi e konsolidimi i besimit në stabilitetin financiar të sistemit tonë bankar ka përkrahur gjithashtu këtë zhvendosje.

Ecuria e portofolit të kredisë tregon se edhe pse norma vjetore e zgjerimit të portofolit të kredisë gjatë vitit 2011 ka qenë në një trend rritës, rimëkëmbja e saj është e ngadaltë. Zhvillimet në portofolin e kredisë edhe gjatë tremujorit të tretë, kanë reflektuar një kërkesë të dobët për kredi si nga bizneset ashtu edhe nga individët, në veçanti për financimin e projekteve afatgjata. Gjithashtu përkeqësimi i mëtejshëm i cilësisë së portofolit të kredisë së bankave, ka ndikuar në ndjekjen e politikave të kujdesshme në aktivitetin kreditues. Në vrojtimin e aktivitetit kreditues të tremujorit të tretë, bankat vlerësojnë se kushtet e kreditimi janë shtrënguar si për bizneset ashtu edhe për individët dhe pritet të jenë të tilla edhe në tremujorin e ardhshëm.

Portofoli i kredisë gjatë vitit 2011 dhe në veçanti gjatë tremujorit të tretë të vitit, nuk ka pasur zhvendosje të dukshme në kreditimin sipas monedhave. Ky portofol vazhdon të dominohet nga kreditimi në valutë, i cili përbën 67% të totalit. Ndërkohë, kreditimi në lek që prej vitit 2008, kur përbënte vetëm 28% të portofolit, ka rritur peshën në portofolin e kredisë. Financimi i bizneseve zë rreth 70% të totalit të portofolit të kredisë dhe gjatë 3 viteve të fundit ky raport ka qenë në një trend rritës. Në fund të vitit 2007, ky raport shënonte 62%. Kredia për biznese duket të jetë e ndarë në mënyrë të barabartë midis kredive për investim dhe për likuiditet. Paralelisht me këtë ecuri portofoli i kredisë ndaj individëve është tkurrur. Tkurrja e portofolit të kredisë për individë ka pasqyruar rënie të dukshme të kërkesës për kredi nga individët, e ndikuar edhe nga shtrëngimi i kushteve të kreditimit, krahasuar me periudhën e

parakrizës. Financimi i individëve në fund të muajit gusht, përfaqëson rreth 33% të totalit të portofolit. Ndërkohë që portofoli i kredisë për individë vazhdon të dominohet nga kreditimi për blerje banesash, me rreth 77%. Në fund të muajit gusht, kredia për konsum përbën 23% të kredisë së individëve dhe është lehtësisht në rritje krahasuar me fillimin e vitit, kur ajo shënonte 21.8%. Zhvillimet pozitive të kredisë konsumatore gjatë vitit 2011, në dy muajt e fundit, kanë ndikuar në rritjen e këtij raporti ndaj totalit.


2. NDËRMJETËSIMI BANKAR SIPAS MOMEDHËS

2.1 ECURIA E NDËRMJETËSIMIT NË LEKË

Ecuria e ndërmjetësimit në monedhën vendase, në periudhën korrik-gusht, ka ruajtur linjat e vërejtura në dy vitet e fundit. Raporti kredi/depozita në fund të muajit gusht, qëndron në 39.5% nga 39.3% që shënonte në fund të tremujorit të dytë të vitit.


Në muajt korrik-gusht, kredia në lekë është rritur mesatarisht me 14.3% në terma vjetorë, duke ruajtur të njëjtën normë rritjeje me tremujorin e dytë të vitit. Burimi i rritjes së kredisë në lekë, në ndryshim nga më parë, ka qenë kredia për individë. Në periudhën korrik-gusht, kredia në lekë për individë shërbeu për të kompensuar edhe rënien e lehtë të kredisë në lekë për biznese. Përveç kredisë konsumatore, e cila përgjithësisht akordohet në lekë, monedha vendase po gjen përdorim më të madh edhe në kredinë hipotekare, duke reflektuar një faktorizim më të madh të rrezikut të kursit të këmbimit në aftësinë për të shlyer kredinë.

Grafik 3. Ecuria e ndërmjetësimit në lekë.



Depozitat në lekë janë rritur mesatarisht me 11.6% në periudhën korrik-gusht, një ritëm ky i krahasueshëm me atë të vërejtur në pjesën e parë të vitit. Fluksi neto mujor i tyre, gjatë kësaj periudhe rezultoi 0.3 miliardë lekë, nga 3.7 miliardë lekë që ishte në tremujorin e dytë të vitit. Ky ngadalësim të flukseve neto të depozitave në lekë, është në linjë më sjelljen sezonale të tyre, ku gjatë muajve të verës ato shfaqin rënie për shkak të shpenzimeve për pushimet verore.

Grafik 4. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë ka vijuar të bjerë më tej në muajt korrik-gusht. Në muajin gusht, ajo rezultoi 5.97%, nga 6.71% dhe 7.53% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të dytë dhe të parë të vitit. Ngushtimi i kostos së ndërmjetësimit ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së normës së interesit të depozitave, ndërkohë që kostoja e kredisë, përtej luhatshmërisë mujore, ka patur një trend të lehtë rënës, duke shënuar 11.39% në fund të muajit gusht. Edhe pse norma e bonove të thesarit 12-mujore, e cila shërben si normë referencë në përcaktimin e kredive në lekë, është rritur në muajt e fundit, normat e interesit të kredisë ka ardhur në rënie.

2.2 ECURIA E NDËRMJETËSIMIT NË VALUTË (EURO)

Ndërmjetësimi në valutë në muajt korrik-gusht, ka shfaqur një ecuri në linjë me zhvillimet në muajt e mëparshëm. Megjithë rritjen e kreditimit në valutë

Grafik 5. Ecuria e ndërmjetësimit në euro.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

gjatë këtyre dy muajve, raporti kredi/depozita është reduktuar, si pasojë e rritjes më të madhe të depozitave në valutë, një sjellje kjo sezonale e aktivitetit depozitues në sistemin bankar. Në fund të muajit gusht, ky raport qëndron në 84.6%, nga 88.3% që shënonte në fund të tremujorit të dytë të vitit.

Në muajt korrik-gusht, kredia në valutë është zgjeruar me një fluks mesatar mujor prej 3.4 miliardë lekësh, ose rreth 50% më shumë se në gjashtë muajt e parë të vitit. Ecuria e saj është nxitur nga kërkesa e bizneseve për financim në valutë, e cila në këta dy muaj ka qenë kryesisht për nevoja të financimit të kapitalit qarkullues. Ndërkohë, kreditimi i individëve në valutë vijon të jetë i ngadaltë, ndikuar jo vetëm nga ecuria e dobët e tregut të pasurive të paluajtshme, por edhe nga një kujdes i shtuar i individëve dhe bankave në kredidhënien në valutë. Në terma vjetorë, ritmet e kreditimit në valutë qëndrojnë në 12.1% në fund të muajit gusht, ose rreth 2.1 pikë përqindje më lart se në fund të muajit qershor.

Ecuria e depozitave në valutë në muajt korrik-gusht ka ndjekur sjelljen sezonale të saj për këtë periudhë të vitit. Fluksi neto i depozitave në valutë për këtë periudhë, rezultoi 25.3 miliardë lekë. Rreth 90% të këtij fluksi e përbëjnë depozitat e individëve, pjesa më e madhe e të cilave të vendosura në depozita me afat. Në terma vjetorë, rritja e stokut të depozitave në monedhë të huaj ka vijuar ngadalësimin në 16.4%.



Përtej luhatshmërisë mujore, kostoja e ndërmjetësimit në euro në muajt korrik-gusht, ka qëndruar thuhajse e pandryshuar në terma mesatarë. Ajo rezultoi 5.0%, nga 5.1% në dy tremujorët e parë të vitit. Ashtu si dhe në tremujorin e dytë, qëndrueshmëria e koston së ndërmjetësimit ka ardhur si pasojë e rritjes së njëkohshme të normës së interesit të depozitave dhe asaj të kredisë.


Rritja e koston së kredisë në euro në muajt korrik-gusht, është e lidhur edhe me natyrën e kredisë në euro të dhënë gjatë këtyre muajve, e cila ka qenë

kryesisht për financimin e kapitalit qarkullues. Në përgjithësi, normat e interesit të kredive në euro vijojnë të jenë ndjeshëm më të larta se normat referencë të monedhës evropiane në tregjet e huaja ndërbankare, duke reflektuar normat më të larta të depozitave në euro në vend. Diferenca mes këtyre të fundit dhe normave Euribor është rritur gjatë këtyre dy muajve, si rrjedhojë e ofertave promociionale të disa bankave të sistemit, me qëllim thithjen e fluksit të shtuar të depozitave të reja gjatë këtyre muajve.

2.3 ECURIA E ELEMENTEVE JOKOSTO NË NDËRMJETËSIM

Ecuria e ndërmjetësimit bankar, përveç normës së interesit, ndikohet edhe nga elementë jokosto të kreditimit, të cilët përcaktohen nga bankat dhe ndikojnë kërkesën për kredi. Në përgjithësi vërehet se, edhe pse normat e interesit të kredive kanë shënuar rënie, elementë të rëndësishëm në përcaktimin e aftësisë së kredimarrësve potencialë për të marrë kredi mbeten ende të shtrënguar. Në tremujorin e tretë të vitit 2011, duket se bankat i kanë shtrënguar disa nga këta tregues, në ndryshim nga sjellja lehtësuese e tyre e vërejtur në tremujorin e dytë dhe të parë të vitit.


Kushtet e kreditimit për bizneset kanë vijuar të shtrëngohen në tremujorin e tretë të vitit, duke reflektuar kryesisht shqetësimin e bankave për rritjen e kredive me probleme dhe situatën makroekonomike në vend. Ndërkohë elementët çmim të kredidhënies- marzhi për kreditë me rrezik normal dhe komisionet-kanë ruajtur kahun lehtësues, sikurse në tremujorin e dytë. Kushtet e tjera të kreditimit, si maturiteti i kredisë dhe madhësia e saj, në ndryshim nga një tremujor më parë, pozicionohen më të shtrënguara. Të dy këta faktorë së bashku me rritjen e mëtejshme të kërkesave për kolateral, vazhdojnë të




kufizojnë ndjeshëm aftësinë kredimarrëse të bizneseve.

Kushtet e financimit për individët, në ndryshim nga tendenca e vërejtura në pjesën e parë të vitit, paraqiten më të shtrënguara. Shtrëngimi i standardeve

vihet re në vijueshmërinë e politikave të tremujorëve të tjerë, si tek ulja e madhësisë së kredisë së disbursuar, në kërkesat për koletaral si dhe në raportin e kështit ndaj të ardhurave. Ndërkohë që politikat lehtësuese kanë vijuar të aplikohen nëpërmjet uljes së marxhit për kredinë për individët si dhe nëpërmjet uljes së komisioneve. Në tërësi, ecuria e këtyre kushteve është ndikuar nga vlerësimet e bankave për gjendjen financiare të individëve, përkeqësimi i cilësisë së portofolit të kredive për individë, si dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme.




Aneks A. Ecuria e depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Aneks B. Ecuria e portofolit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë

